

Kthimi në arsimin e hershëm dhe parashkollor nga 14.5.2020 sipas këndvështrimit të grupeve më të rrezikuara

Bazuar në Institutin e mirëqenjes shëndetësore (THL) nga kjo sëmundje e vështirë e koronavirusit fëmijët infektohen në raste të rralla, dhe se rreziku nuk është rritur si për fëmijët e shëndoshë ashtu edhe për ata fëmijë dhe të rinjë, të cilët për sëmundjet e tyre fillestare kanë trajtim të balancuar. Grupit të rrezikuar nga koronavirusi i takojnë ata fëmijë, të cilëve për ndryshe sëmundjet e tyre fillestare ju shkaktojnë rrezik të zgjeruar për infektim serioze.

Edukimi në fëmijërinë e hershme:

Prindi vendos për pjesëmarrjen e fëmijës në edukimin e hershëm duke filluar nga 14.5.2020.

Nëse fëmija ose anëtari i familjes së tij i takon grupit me rrezikshmëri infektimi, prindi mundet sipas nevojë që të vlerësoj kthimin e fëmijës në edukimin e hershëm së bashku me mjekun që e trajton shërimin. Çertifikatë mjekësore nuk ka nevojë të sjellet në edukimin e hershëm. Prindi e njofton vendin e edukimit të hershëm për mosardhjen e fëmijës.

- Koronavirusi (COVID-19) te fëmijët dhe udhëzimet për grupet e rrezikuara (nga HUS):
[https://www.hus.fi/en/patients/Documents/Instructions%20regarding%20children%20at%20risk%20for%20severe%20coronavirus%20\(COVID-19\)%20infection.pdf](https://www.hus.fi/en/patients/Documents/Instructions%20regarding%20children%20at%20risk%20for%20severe%20coronavirus%20(COVID-19)%20infection.pdf)

Mësimi parashkollor:

Fëmija duhet të merr pjesë në mësimin parashkollor nga 14.5.2020, nëse ai apo anëtarët tjerë të familjes së tij nuk i takojnë grupit me rrezikshmëri nga infektimi.

Spitalet universitare në bashkëpunim me THL:në kanë hartuar listën e atyre sëmundjeve, që konsiderohet se fëmijët të cilët vuajnë prej tyre i takojnë grupit me rrezik nga infektimi, nëse sëmuren nga koronavirusi mund të kenë një formë serioze të sëmundjes.

- Koronavirusi (COVID-19) te fëmijët dhe udhëzimet për grupet e rrezikuara (nga HUS):
[https://www.hus.fi/en/patients/Documents/Instructions%20regarding%20children%20at%20risk%20for%20severe%20coronavirus%20\(COVID-19\)%20infection.pdf](https://www.hus.fi/en/patients/Documents/Instructions%20regarding%20children%20at%20risk%20for%20severe%20coronavirus%20(COVID-19)%20infection.pdf)

Nëse në familjen e fëmijës ka anëtar të familjes që i takon grupit me rrezik nga infektimi

THL ka hartuar listën e sëmundjeve, të cilat mundën me i rrezikue seriozisht të rriturit në rastë se ata infektohen me koronavirusin:

<https://thl.fi/en/web/infectious-diseases/what-s-new/coronavirus-covid-19-latest-updates/coronavirus-covid-19/risk-groups-for-coronavirus-disease>

Nëse në familjen e fëmijës së moshës parashkollore ka anëtar familje që i takon grupit me rrezik nga infektimi dhe prindi shpreson, që fëmija për këtë arsye të mos merr pjesë në mësimin në klasë, leja për mungesë prindit i jepet nga drejtuesi i qerdhes. Çertifikatë mjekësore nuk nevojitet.